



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË  
DHËNAVE PERSONALE

Nr. 602/3 Prot.

Tiranë, më 9/5 /2017

VENDIM

Nr. 69, datë 9/5 /2017

Në mbështetje të nenit 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, pikës 3 dhe 5 të nenit 24, të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", shkronjës a) të nenit 31/1 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" i ndryshuar, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale,

V Ë R E N:

Ankuesi, Qendra "Lex Ferenda", përfaqësuar nga Z. \_\_\_\_\_, sipas Autorizimit datë 15.03.2017, lëshuar nga Znj. \_\_\_\_\_ në cilësinë e Drejtorit Ekzekutiv, ka depozituar pranë Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim quajtur "Komisioneri") Formularin e Ankesës nr. 602 Prot., datë 31.03.2017, me objekt "*Ankim ndaj refuzimit për dhënie të informacionit dhe kopje të dokumenteve zyrtare*", kundër Autoritetit Publik "Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore" (në vijim quajtur "Autoriteti Publik"). Ankuesi, nëpërmjet shkresës së datës 16.03.2017, ka paraqitur pranë Autoritetit Publik, kërkesën për informacion si më poshtë:

1. *Një kopje të kontratës së koncesionit për ndërtimin e hidrocentraleve "HEC Qafë e Shulit 1,2,3", me shoqëri zbatuese të projektit HOXHA-ENERGY me NIPT L12608205L, duke përfshirë dokumentat si më poshtë:*
  - *Projektin e Zbatimit*
  - *Relacionin e kushteve gjeologo-inxhinjerieke*
  - *Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis*
  - *Lejen e përdorimit të ujit*
  - *Lejen arkeologjike*
  - *Lejen Mjedisore*
2. *Një kopje të kontratës së koncesionit së formës BOT për ndërtimin e hidrocentralit "Driza I", lidhur nga Ministria e Energjisë, Tregtisë dhe Energjitikës (Autoriteti Kontraktues) me Bashkimin e përkohshëm të shoqërive "Gerti-Metal" shpk dhe "Everest" shpk*

*(Koncesionari), me Nr. 10285 Rep & Nr. 3309 Kol., datë 06.09.2013, duke përfshirë dokumentat si më poshtë:*

- *Projektin e Zbatimit*
- *Relacionin e kushteve gjeologo-inxhinjerike*
- *Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis*
- *Lejen e përdorimit të ujit*
- *Lejen arkeologjike*
- *Lejen Mjedisore*

Autoriteti Publik i është përgjigjur kërkuarit me shkresën nr. 2489/1 Prot., datë 28.03.2017 duke u shprehur se: Në zbatim të VKM-së 547, datë 09.08.2006 “Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore” të ndryshuar, kjo e fundit monitoron zbatimin e përmbushjes së detyrimeve kontraktuale të Kontratave të Koncesionit për Hidrocentralet. Gjithashtu, Kontratat e Koncesioneve të kërkuara në shkresën e datës 16.03.2017 kanë në përmbajtjen e tyre nenin 27 “Konfidencialiteti”, ku përcaktohet se: *“Secila nga palët duhet të konsiderojë si konfidenciale të gjithë dokumentat dhe informacionet e tjera në lidhje me projektin, qofshin këto tregtare apo teknike, dhe nuk duhet t’ja bëjë të ditura një pale të tretë, të gjithë apo një pjesë të dokumentit apo informacionit, pa miratimin e palës tjetër, përveçse për qëllimin e përmbushjes së kushteve të kësaj kontrate”.*

Me pretendimin se është cënuar në të drejtën për informim, ankuesi ka paraqitur ankimin nr. 602 Prot., datë 31.03.2017 pranë Komisionerit duke i kërkuar ushtrimin e kompetencave që i njeh ligji për rastet e refuzimit të dhënies së informacionit.

Në ndjekje të procedurës për shqyrtimin administrativ të çështjes, Komisioneri, me urdhrin nr. 119 Prot, datë 26.04.2017, ka urdhëruar kryerjen e inspektimit administrativ pranë Autoritetit Publik.

Gjatë inspektimit u konstatua se kërkesa e Qendrës “Lex Ferenda” është depozituar pranë Autoritetit Publik dhe është regjistruar me nr. 2489 Prot., datë 16.03.2017.

Koordinatori për të Drejtën e Informimit pranë Autoritetit Publik sqaroi grupin e inspektimit se sipas interpretimit të Drejtorisë së Shërbimeve Juridike, për nivelin e dhënies së informacionit, në lidhje me Kontratat Koncesionare të kërkuara në pikat 1 dhe 2 të shkresës së datës 16.03.2017 (*“Një kopje të kontratës së koncesionit për ndërtimin e hidrocentraleve “HEC Qafë Shulit 1,2,3”, me shoqëri zbatuese të projektit HOXHA-ENERGY me NIPT L12608205L” dhe “Një kopje të kontratës së koncesionit së formës BOT për ndërtimin e hidrocentralit “Driza 1”, lidhur nga Ministria e Energjisë, Tregtisë dhe Energjitikës (Autoriteti Kontraktues) me Bashkimin e përkohshëm të shoqërive “Gerti-Metal” shpk dhe “Everest” shpk (Koncesionari), me Nr. 10285 Rep & Nr. 3309 Kol., datë 06.09.2013”*), ato përmbajnë në nenin 27 të tyre klauzolën e konfidencialitetit. Gjithashtu sipas përfaqësuesve të AKBN, kjo e fundit monitoron zbatimin e përmbushjes së detyrimeve kontraktuale pa qenë palë në lidhjen e këtyre kontratave dhe si



rrjedhje të drejtën për dhënien e këtij informacioni e ka Ministria e Energjisë dhe Industrisë si Autoriteti Kontraktor.

Për sa i përket *Projektit të Zbatimit, Relacionit mbi kushtet gjeologo-inxhinjerie dhe Raportit të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis*, sipas AKBN ato janë informacione që konsiderohen teknike dhe të drejtën e dhënies së këtij dokumentacioni e ka Autoriteti Kontraktues “Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjitikës, sot Ministria e Energjisë dhe Industrisë”, si dhe “Koncesionari”.

Lidhur me *Lejen e përdorimit të ujit, Lejen arkeologjike dhe Lejen Mjedisore*, AKBN nuk e disponon dokumentacionin e kërkuar, provuar kjo me shkresat nr. 2428 Prot, datë 04.03.2016, “Kërkesë për Plotësim dokumentacioni”, nr. 7618 prot, datë 26.08.2016, “Njoftim për monitorimin dhe plotësim dokumentacioni...”, drejtuar shoqërive koncensionare në fjalë.

Nga shqyrtimi i ankimit dhe nga konsultimi i legjislacionit përkatës rezulton se, informacioni i kërkuar nga Qendra “Lex Ferenda”, pavarësisht nëse është i prodhuar apo administrohet nga autoriteti publik, përmbush kërkesat e pikës 2, të nenit 2, të Ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, sipas të cilit “*informacion publik*” konsiderohet çdo e dhënë e regjistruar në çfarëdo lloj forme dhe formati, gjatë ushtrimit të funksionit publik pavarësisht nëse është përpiluar ose jo nga Autoriteti Publik”.

Bazuar në sa më sipër, pavarësisht faktit se AKBN nuk është palë në Kontratat e Koncesionit, fakti që ajo i administron këto dokumente në kuadër të veprimtarisë që ushtron me ligj, bën që ky institucion të jetë i detyruar për dhënien e informacionit sipas Ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”. Argumenti se *Projekti i Zbatimit, Relacioni mbi kushtet gjeologo-inxhinjerie dhe Raporti i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis* janë informacione teknike dhe si të tilla mund të jepen vetëm nga Ministria e Energjisë dhe Industrisë nuk është i bazuar në ligj. Sipas pikës 2 të nenit 12 të Ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” arsyeja e vetme që justifikon dërgimin e kërkesës tek një autoritet tjetër është mungesa e informacionit të kërkuar.

Sipas pikës 3 të nenit 3 të ligjit sipërcituar, “*Çdo person ka të drejtë të njihet me informacionin publik, nëpërmjet dokumentit origjinal ose duke marrë një kopje të tij në formën ose formatin që mundëson akses të plotë në përmbajtjen e dokumentacionit*”.

Sa i përket pretendimit lidhur me klauzolën e konfidencialitetit, fryma e Ligjit nr. 9663, datë 18.12.2006 “Për koncesionet” i ndryshuar, i cili zbatohet për kontratat e koncesionit objekt kërkesë për informacion, nuk është ajo e mosbërjes publike të kontratave të koncesionit. Neni 24 i Ligjit 9663 datë 18.12.2006 “Për koncesionet” i ndryshuar përcakton se: “*Autoriteti kontraktues ruan konfidencialitetin e të gjitha të dhënave teknike, ekonomike, financiare etj. të propozimeve të bëra nga ofertuesit. Nëse nuk parashikohet me ligj, me vendim gjyqate apo në kërkesën për propozim, palët në bisedime nuk i deklarojnë personave të tjerë informacione teknike, të dhëna për çmimin dhe elemente për diskutimet, komunikimet dhe bisedimet, në përputhje me dispozitat e mësipërme, pa pëlqimin e palës tjetër*”.

Gjithashtu pika o) e nenit 27 të Ligjit 9663 datë 18.12.2006 “Për koncesionet” i ndryshuar, parashikon ndër çështjet që rregullon kontrata e koncesionit edhe të drejtat dhe detyrimet e palëve lidhur me informacionin konfidencial. Pra, konfidencialiteti nuk zbatohet mbi kontratën në tërësi.



por vetëm mbi atë informacion që sipas nenit 24 konsiderohet konfidencial dhe që palët mund ta rregullojnë dhe në kontratën e koncesionit.

Ligji nr. 125/2013 "Për koncesionet dhe partneritetin publik privat", i ndryshuar i cili ka shfuqizuar Ligjin 9663 datë 18.12.2006 "Për koncesionet" i ndryshuar, në nenin 15 të tij parashikon se: *"Dispozitat e ligjit të prokurimit publik, që rregullojnë konfidencialitetin, zbatohen edhe për koncesionet/partneritetet publike private të rregulluara me këtë ligj. Neni 25 i Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar, përcakton kufizime mbi Autoritetin Publik lidhur me publikimin e informacionit të marrë nga operatorët ekonomikë, të cilësuar si konfidencial, duke përfshirë në këtë kategori aspektet teknike, sekretet tregtare si dhe informacionet konfidenciale të ofertave.*

Pra, fryma e përgjithshme e legjislacionit është ajo e publikimit të kontratës së koncesionit/partneritetit publik privat/punëve publike duke kufizuar publikimin e informacionit konfidencial të marrë nga Autoriteti Publik prej subjekteve konkurrese në fazën e paraqitjes së propozimeve/ofertave.

Një kufizim i tillë përcaktohet dhe në pikën 1 të nenit 17 të Ligjit 119/2014 "Për të drejtën e informimit".

Sa më sipër vlerësohet se, kufizimet e pasqyruara në legjislacionin e zbatueshëm nuk prekin në mënyrë tërësore informacionin e kërkuar dhe personat përgjegjës duhet ta vënë atë në dispozicion të kërkuarit në përputhje me pikën 6 të nenit 17 të Ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit" i cili përcakton se: *"Nëse kufizimi prek vetëm një pjesë të informacionit të kërkuar, pjesa tjetër nuk i refuzohet kërkuarit. Autoriteti Publik tregon qartë pjesët e dokumentacionit përkatës që janë refuzuar, si dhe në bazë të cilës pike të këtij neni është bërë ky refuzim".*

Theksojmë, se e drejta për t'u informuar është një prej të drejtave themelore të njeriut, e parashikuar në nenin 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Kjo e drejtë duhet parë e lidhur ngushtë me parimin e transparencës dhe llogaridhënies, si një shtyllë tjetër themelore e shtetit të së drejtës. Funksionimi i tyre do të ishte në interesin e të dy palëve.

Në këto kushte, në lidhje me ankesën Qendrës "Lex Ferenda", përfaqësuar me autorizim nga Z. kundër Autoritetit Publik, Komisioneri vlerëson se duke pasur parasysh sa është parashtruar më sipër lidhur me kufizimet në dhënien e informacionit, ankimi duhet pranuar pjesërisht.

## **PËR KËTO ARSYE**

Bazuar në shkronjat b) dhe ç) të pikës 5 të nenit 24, nenit 25 të ligjit nr.119/2014 "Për të drejtën e informimit", shkronjën a) të pikës 1 të nenit 18 të ligjit nr 49/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëve shjeve administrative",

## VENDOSA:

1. Pranimin në mënyrë të pjesshme të ankesës Nr. 602 Prot., datë 31.03.2017 të Qendrës "Lex Ferenda", përfaqësuar me autorizimin datë 15.03.2017 nga Z. . . ndaj Autoritetit Publik "Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore", me objekt "Ankim ndaj refuzimit për dhënie të informacionit dhe kopje të dokumenteve zyrtare".
2. Urdhërimin e Autoritetit Publik, për vënien në dispozicion të dokumentacionit të kërkuar sipas kërkesës për informim datë 16.03.2017 në përputhje me pikën 6 të nenit 17 të Ligjit nr. 119/2014 "Për të Drejtën e Informimit" dhe nenin 24 të Ligjit 9663 datë 18.12.2006 "Për konçesionet" i ndryshuar, brenda datës 17. 5 2017.
3. Kundër këtij vendimi palët kanë të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni, sipas nenit 25 të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit".
4. Ky vendim u dha sot në datë 9. 5 2017.

